



Drejtësia dhe qytetarët
Pravda i ljudi
Justice and the people

Perceptimet dhe përvojat me sistemin e drejtësisë në Kosovë

Raport fillestar për rezultatet e sondazhit në mbarë Kosovën

27 Tetor 2011



PRISM RESEARCH
marketing • media • social research



Drejtësia dhe qytetarët
Pravda i ljudi
Justice and the people

Perceptimet dhe përvojat me sistemin e drejtësisë në Kosovë

Raport fillestar për rezultatet e sondazhit në mbarë Kosovën

Hyrje dhe metodologjia

Për mbledhjen e informatave për fushatën *Drejtësia dhe Qytetarët*, Prism Research zhvilloi një sondazh mbarë-kosovar gjatë muajve gusht dhe shtator 2011. Qëllimi i këtij sondazhi ishte që të mblidhen informata për perceptimet, qëndrimet dhe përvojat e qytetarëve në lidhje me sistemin e drejtësisë penale.

Për këtë sondazh u konsultuan tri grupe të fokusit me nga 12 persona secili, për të ekzaminuar çështjet që kanë të bëjnë me sistemin e drejtësisë penale dhe për të formuluar pyetjet që do të shtrohen gjatë këtij sondazhi. Pastaj hulumtimi u bë përmes intervistave kokë-më-kokë duke përdorur pyetësorët e sondazhit të përgatitur në mënyrë të veçantë për të analizuar këto çështje. Mostra përbëhej nga 1,000 të intervistuar të moshës mbi 18 vjeçare.

Gjetjet kryesore

Sa kuptohet sistemi i drejtësisë penale

Njohuritë dhe besimi në sistemin e drejtësisë: Besimi në sistemin e drejtësisë penale është i kufizuar, ku 64.7% e të intervistuarve raportuan se ose nuk kanë besim ose kanë shumë pak besim në këtë sistem. Pothuaj një e treta e të intervistuarve raportuan se ata nuk do të ishin të gatshëm që të shfrytëzojnë sistemin e drejtësisë në një rast penal nëse do të ishin viktimat të ndonjë krimi (31.5%). Kur u pyetën se sa janë të kënaqur me sistemin e drejtësisë penale, shumica e të intervistuarve treguan se janë të pakënaqur me efikasitetin (59.2%), me shpenzimet (73.3%), me procedurat burokratike (58.4%), me drejtësinë (69.2%), dhe me rezultatet (72.8%) e sistemit. Përafërsisht 45% theksuan se ata nuk besojnë se gjykatat penale do të kenë konsiderata për të drejtat e viktimave. Shumë të intervistuar deklaruan se u mungon besimi se gjykatat penale i respektojnë procedurat e duhura (42.3%), se marrin vendime të bazuara në dëshmi (40.5%), dhe se i trajtojnë rastet me kohë (56.3%). Për më tepër, shumë prej tyre u mungojnë njohuritë për funksionin e gjykatave (46.8%) dhe për procesin e drejtësisë penale (50.8%).

Reformat në sistemin e drejtësisë penale: Shumica e të intervistuarve nuk kishin dëgjuar kurrë për reformat në sistemin e drejtësisë penale (84.4%) ose për ligjet e reja që kanë për qëllim të përmirësojnë sistemin e drejtësisë penale (86.2%). Të intervistuarit u ndanë në dy grupe rreth asaj se a mendonin se reformat dhe ligjet e reja do të jenë efektive, ku përafërsisht një e treta e tyre shprehën besimin se reformat do të jenë efektive, një e treta e tyre nuk e besonte këtë dhe një e treta deklaruan se nuk e dinë. Shumica e të intervistuarve po ashtu nuk kishin dëgjuar kurrë për pjesëmarrjen e qytetarëve në reformimin e sistemit të drejtësisë penale (86.5%).

Si informohen njerëzit për gjyqësorin: Pothuaj një e katërta e të intervistuarve (23.5%) deklaruan se nuk janë të kënaqur me burimet e informimit që janë në dispozicion për sistemin e drejtësisë penale, ndërsa 46.9% deklaruan se janë të kënaqur, kurse pjesa tjetër e të intervistuarve theksuan se nuk e dinin apo nuk deshën të përgjigjeshin. Burimi më i zakonshëm i informimit rreth gjyqësorit ishte TV-ja dhe diskutimet me miqtë dhe të afërmit. Pothuaj 60% e të intervistuarve që ishin përpjekur të mësonin rreth sistemit ligjor deklaruan se nuk kishin qenë në gjendje të gjejnë informacionet që ju duheshin, dhe interneti kishte qenë burimi më i zakonshëm i informimit.

Përfshirja në sistemin e drejtësisë penale: Vetëm 15.9% e të intervistuarve kishin qenë të përfshirë në raste penale. Prej tyre, shumica kishin konstatuar se profesionistët e mëposhtëm që ishin të përfshirë në rastin e tyre ishin treguar profesional: avokatët (72.3%), gjyqtarët (67.3%), prokurorët (57.2%), dhe personeli administrativ (57.9%). Vonesa në procedimin e rasteve ishte problem për 45.3% e të intervistuarve të cilët deklaruan se rastet e tyre nuk ishin proceduar në mënyrë të shpejtë. Përafërsisht gjysma e atyre që kishin qenë të përfshirë në një rast penal deklaruan se ishte lehtë për tu marrë me sistemin e drejtësisë penale (51.6%), por 23.3% deklaruan se kjo ishte e vështirë; pjesa tjetër refuzuan të përgjigjeshin në këtë pyetje ose deklaruan se nuk ishin të sigurt për këtë.

Mekanizmat e ankesës

Mundësia për tu ankuar kundër një gjyqtari, prokurori ose polici: Vetëm 30% e të intervistuarve e dinë se ekzistojnë institucione në kuadër të sistemit gjyqësor dhe të qeverisë nga të cilat ata mund të kërkojnë ndihmë nëse një gjyqtar, prokuror apo polic nuk e kryen punën e tij/saj si duhet. Pothuaj gjysma e tyre nuk janë të sigurt se a mund të parashtrajnë ankesë ose të kërkojnë ndihmë nëse mendojnë se gjykata nuk ja ka dalë që të trajtojë rastin e tyre si duhet (49.1%).

Shkalla e sjelljeve të këqija (shpërdorimit) nga policia, prokurori, gjyqtari ose avokati: Një numër i konsiderueshëm i të intervistuarve deklaruan të kenë përjetuar të paktën një herë ndonjë lloj të sjelljes së keqe (shpërdorimi) nga policia (9.1%), prokurorët (9.7%), gjyqtarët (8.9%), ose avokatët (8.6%). Megjithatë, vetëm, 4.2% e të intervistuarve që ishin keqtrajtuar kishin paraqitur ankesë. Sa i përket zyrtarëve të ndryshëm qeveritarë, të intervistuarit duket se janë më së shumti të kënaqur me policinë (52.7%), pasuar nga avokatët (37.6%), gjyqtarët (27.3%), dhe prokurorët (23.9%).

Qëndrimet për policinë dhe njohuritë për të paraqitur ankesë kundër policisë: Shumica e të intervistuarve kanë besim në policinë e Kosovës (78%). Për më tepër, shumica e të intervistuarve që kanë pasur kontakte me policinë theksojnë se policia plotësisht i ka përmbushur pritjet e tyre. Megjithatë, 41.4% theksuan se policia shpesh i keqpërdor kompetencat dhe privilegjet e saj dhe 40.7% deklaruan se niveli i korrupsionit në polici është alarmues. Vetëm 24.8% e të intervistuarve e dinë se si dhe ku duhet të parashtrohet ankesa kundër policisë.

Njohuritë për prokurorët dhe për paraqitjen e ankesës kundër prokurorëve: Qytetarët në përgjithësi kanë shumë pak njohuri për prokurorët. Vetëm 2.3% e të intervistuarve kishin pasur kontakte me prokurorinë në lidhje me ndonjë krim. Dhe shumica e të intervistuarve nuk dinë sa duhet për të përshkruar rolin e prokurorit (79%). Prej atyre që kanë pasur kontakte me prokurorinë, 43.5% deklaruan se prokurori nuk e kishte trajtuar çështjen e tyre mirë, përderisa 17.4% deklaruan se ai kishte vepruar si duhet. Vetëm 11.9% e dinë se mund të bëhet ankesë kundër një prokurori.

Qëndrimet për avokatët dhe njohuritë për paraqitjen e ankesës kundër avokatëve: Tri të katërtat e të intervistuarve mendojnë se avokatët janë kompetent që të merren me të gjitha rastet e tyre, por vetëm 46.6% besojnë se avokatët janë efektiv në rastet penale. Vetëm 19.2% e të intervistuarve e dinë se mund të bëhet ankesë kundër një avokati.

Qëndrimet për gjyqtarët dhe njohuritë për paraqitjen e ankesës kundër gjyqtarëve: Përafërsisht 40% e të intervistuarve besojnë se gjyqtarët janë të anshëm (39.8%) në marrjen e vendimeve të tyre, dhe afërsisht tri të katërtat e tyre besojnë se gjithmonë ose nganjëherë ka ndikim politik në emërimin e gjyqtarëve. Vetëm 22.2% e të intervistuarve e dinë se mund të bëhet ankesë kundër një gjyqtari.

Viktimat në sistemin e drejtësisë penale

Trajtimi i dhunës në familje: Dy të tretat e të intervistuarve (65.5%) mendojnë se rastet që kanë të bëjnë me dhunën në familje duhet të trajtohen nga sistemi i drejtësisë, por një e treta tjetër ose mendojnë se sistemi i drejtësisë nuk duhet të merret me këto raste ose nuk e dinë. Shtatëdhjetë për qind e të intervistuarve mendojnë se policia merret me rastet e dhunës në familje ose shumë mirë ose në mënyrë adekuate. Megjithatë, të intervistuarit kanë fjalë më pak të mira për prokurorët dhe gjyqtarët, ku më pak se gjysma deklaruan se prokurorët dhe gjyqtarët merren me rastet e dhunës në familje shumë mirë ose në mënyrë adekuate (47.6 %, respektivisht 49.1%). Një pakicë e konsiderueshme beson se policia (14.9%), prokurorët (18.5%), dhe gjyqtarët (19%) ose i trajtojnë këto raste dobët ose i injorojnë ato.

Të drejtat e viktimave në sistemin e drejtësisë penale: Mbi dyzet e pesë për qind e të intervistuarve nuk e dinë nëse viktimat kanë ndonjë të drejtë në sistemin e drejtësisë penale. Madje, pothuaj gjysma (48.2%) nuk janë të sigurt se a duhet të

kenë viktimat më shumë të drejta. Vetëm 13.4% janë në dijeni se ekzistojnë institucione qeveritare për mbrojtjen e të drejtave të viktimave. Shumica e të intervistuarve besojnë se policia duhet të jetë përgjegjëse për të siguruar të drejtat e viktimave në sistemin e drejtësisë penale (56.1%), por pak më pak mendojnë se edhe prokurorët (37.5%) ose gjyqtarët (30.5%) që duhet të kenë përgjegjësi të njëjtë.

Korrupsioni dhe mitosja në sistemin e drejtësisë penale

Perceptimet e korrupsionit në sistemin e drejtësisë penale: Mbizotëron besimi se aktorët në sistemin e drejtësisë janë të korruptuar. Shumë të intervistuar deklaruan se besojnë se gjyqtarët (57.6%), prokurorët (50.9%), personeli administrativ i gjykatës (39.8%), dhe avokatët (38.8%) janë të korruptuar. Shumë të intervistuar po ashtu besojnë se personeli që punon në mekanizmin e ankesave (33.6%) dhe në polici (27%) janë të korruptuar.

Mitosja në sistemin e drejtësisë penale: Pothuaj 40% e të intervistuarve besojnë se dhënia e mitos është e domosdoshme për të fituar një rast penal (39.8%). Megjithatë, shumica deklaruan se as ata e as anëtarët e familjes së tyre nuk i kanë dhënë mitë askujt në dy-tre vitet e fundit (89.5%).

Temat e veçanta që kanë të bëjnë me sistemin e drejtësisë penale

Drejtësia për të mitur: Përafërsisht një e treta e të intervistuarve besojnë se delinkuentët e mitur trajtohen mirë në sistemin e drejtësisë (35.3%), dhe përafërsisht dy të tretat besojnë se të miturit duhet të trajtohen ndryshe nga ajo se si trajtohen të rriturit që kryejnë krime (65.7%). Kur pyeten për të sugjeruar ndonjë alternativë ndaj burgosjes, sugjerimet më të shpeshta ishin këshillimi psikologjik (33%) dhe vijimi i rregullt i shkollës (21.7%).

Mbrojtja e dëshmitarëve: Afërsisht dy të tretat e të intervistuarve besojnë se nuk është e sigurt që të jesh dëshmitar në një rast penal (64.8%). Një numër i vogël i të intervistuarve kanë qenë dëshmitarë: 2.9% kanë dëshmuar si dëshmitarë dhe 6.3% të tjerë janë ftuar si dëshmitarë por nuk kanë dëshmuar kurrë. Arsyeja më e shpeshtë për të mos dëshmuar ishte besimi se dëshmia e tyre nuk do sjell kurrfarë dobie, por 4.8% e atyre që janë ftuar si dëshmitarë nuk kanë dëshmuar sepse kanë pasur frikë nga pasojat.

Ndihma juridike: Pothuaj 45% e të intervistuarve nuk e dinë se a mund të marrin qytetarët ndihmë juridike pa pagesë. Vetëm 10.7% e të intervistuarve kanë marrë ndihmë juridike pa pagesë për ndonjë çështje penale në të kaluarën.

Përfundim

Të dhënat e zbuluara nga ky sondazh tregojnë se shumë kosovarë janë të pakënaqur me sistemin e drejtësisë. Përafërsisht një e katërta e atyre që kanë qenë të përfshirë në ndonjë rast penal deklarojnë se e kanë vërejtur se sistemi i drejtësisë penale është i vështirë. Ndonëse shumë prej këtyre personave mund të kenë qenë të pakënaqur me sjelljen e policisë, prokurorëve ose gjyqtarëve gjatë trajtimit të rastit të tyre,

rezultate e sondazhit zbulojnë se shumë kosovarë nuk janë në dijeni se ekzistojnë mekanizma ankimor të cilëve ata do të mund tu drejtoheshin me ankesa për sjelljet e këqija të ndonjë zyrtari. Për më tepër, shumë kosovarë nuk janë në dijeni se çfarë të drejtash kanë viktimat në kuadër të sistemit të drejtësisë penale. Këto rezultate tregojnë se do të ishte mirë që kosovarëve tu jepeshin më shumë informata për mekanizmat e ankesës dhe për të drejtat e viktimave në kuadër të sistemit të drejtësisë penale. Në fund, shqetësimi tepër i madh për korrupsionin vazhdon të mbizotëroj në perceptimet për sistemin e drejtësisë penale, ku më shumë se gjysma e të intervistuarve deklarojnë se gjyqtarët dhe prokurorët janë të korruptuar. Të kuptuarit e perceptimeve dhe përvojave të qytetarëve të Kosovës në lidhje me sistemin e drejtësisë penale do të përbëj gurthemelin mbi të cilin mund të krijohet një fushatë e edukimit të qytetarëve dhe avokimit.



This report is presented by the Justice and the People Campaign, a citizens' campaign that aims to increase access to justice and to foster public demand for justice in Kosovo. The Campaign is implemented by the Center for Legal Aid and Regional Development, the Advocacy Training & Resource Center, and Sejdiu & Qerkini with support from the Public International Law & Policy Group. Funding is provided through a grant from the United States State Department's Bureau of International Narcotics and Law Enforcement Affairs.

